



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Departamenti për Profesione të Lira-Department Slobodnih Profesija- Department of
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr.03/2019

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevi dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbaruesit privat, në çështjen disiplinore ndaj Përmbarueses Private si organ përmbarues, e emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në lidhur me veprimet përmbarimore në lëndën përmbarimore, P.nr. 11/2015, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, Burbuqe Spahiu Kërveshi dhe përmbaruesja private dhe pa prezencën e palës ankuese duke vepruar sipas rekomandimeve të aktgjykimit A.nr.1113/2019 të datës 08.06.2023, i lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, me datë 25.09.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHEN** Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL-03/2019 i datës 09.01.2019, dhe ankesa e paraqitur nga pala ankuese, nga Malisheva, si të pa bazuara.

II

II. Përmbauesja private , si organ përmbaues, e emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, nuk është përgjegjëse për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbaimore P. nr. 11/2015.

A r s y e t i m

Me datën 20.12.2018, pala ankuese ka paraqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë ndaj Përmbaueses private, pranë të cilës ka mbetur edhe në seancën dëgjimore, me të cilën pretendon se përmbauesja private, në mënyrë të vetëdijshme e ka dëmtuar kreditorin .Pas vetë insistimit të kreditorit është bërë e mundur gjetja e adresës së debitorit të cilën gjë përmbauesja nuk e ka bërë me vite, mirëpo edhe pas kësaj është pranuar një email nga përmbauesja lëndore, për të cilën, zyra e përmbaueses ka deklaruar se duhet vazhduar me regjistrimin dhe sekuestrimin e sendeve të debitorit. Më pas është bërë dalja në terren tek debitori, familja-vjehri i debitorit është pajtuar dhe ka bërë pagesë në shumën prej 530.00 euro, me kërkesën që të mos llogaritet kamata. Të gjendur para një situatë të tillë është kërkuar prej kreditorit nga përmbauesja që të hiqet dorë nga interesat dhe ndëshkimet, por të paguhet kryegjëja dhe shpenzimet procedurale. Në llogarinë e kreditorit janë transferuar vetëm 291.75 euro e jo 530.00 euro ashti siç ishte e paraparë me marrëveshje. Më tutje,përmbauesja sipas kreditorit nuk i ka dërguar faturat për pagesë të shpenzimeve tek debitori sikurse ishte kërkuar edhe nga vet debitori, por sipas pretendimit të kreditorit, përmbauesja e ka ndaluar për vete shumën prej 238.25 euro. Andaj, kreditori konsideron se përmbauesja private ka bërë shkelje disiplinore dhe poashtu sipas raportit të lartcekur të Ministrisë së drejtësisë, përmbauesja lëndore ka bërë shkelje edhe për sa i për ket ndërhyrjes në procesverbalin e vendshiqimit në terren si dhe pezullimit të procedurës.

I ka propozuar komisionit që të aprovohet ankesa dhe të ndërmerren masa ndaj përmbaueses private.

Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbaimin Privat, ka paraqitur në Komision Raportin Përfundimtar, ndaj përmbaueses private, lidhur me veprimet përmbaimore për këtë lëndë duke mbetur në tërësi pran raportit të saj të prezantuar në seancën e datës 25.09.2023, edhe pse kjo çështje është e kthyer në rigjykim.

Përmbauesja Private, si në deklaratën e saj para se çështja të kthehet në rigjykim ashtu edhe në seancën dëgjimore të datës 25.09.2023, ka deklaruar se nuk e ndien veten përgjegjëse për asnjë nga veprimet e ndërmarra përmbaimore në këtë rast. I ka propozuar komisionit që të refuzohet

ankesa dhe ti kthehen mjete e paguara sipas aktvendimit të komisionit DPL-03/2019 të datës 03.04.2019, në shumën prej 500.00 euro.

Me vendimin e Komisioni Disiplinor për Përmbaruesit Privat DPL-03/2019 të datës 03.04.2019, përmbaruesja private është shpallur përgjegjëse për shkelje disiplinore dhe i është shqiptuar, gjoba në shumën prej 500.00 euro.

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1113/2019 të datës 08.06.2023, është anuluar vendimi i Komisionit Disiplinor për Përmbaruesit Privat DPL-03/2019 i datës 03.04.2019, dhe lënda është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje.

Komisioni Disiplinor, pasi vlerësoi pretendimin e palës ankuese, pasi që çështja është rikthyer në rishqyrtim dhe rivendosje sipas aktgjykimit të lartcekur, dhe pas mbajtjes së seancës dëgjimore erdhi në përfundim se përmbaruesja lëndore nuk është përgjegjëse për veprimet e ndërmarra përmbarimore e as për ndërhyrjen në procesverbal të vendshiqimit të datës 05.03.2018. Kjo nga shkakut se veprimet e ndërmarra janë kryer në harmoni me dispozitat ligjore, sa i përket shpenzimeve procedurale, që pala ankuese pretendon se është bërë shkelje kur janë ndalur ato shpenzime, përmbaruesja me të drejtë ka ndalur shpenzimet përmbarimore nga shuma e paguar nga debitori.

Për pretendimin se përmbaruesja ka pezulluar dhe ka kërkuar që në rast të vazhdimit të procedurës, kreditori duhet që të parapaguaj shpenzimet përmbarimore, edhe këtu me të drejtë ka kërkuar pagesën e shpenzimeve përmbarimore në avans, pasi të njëjtat shpenzime që i kthehen kreditorit në fund të procedurës , inkasohen nga debitori.

Ndërsa, sa i për ketë pretendimit ankimor se përmbaruesja private ka ndërhyrë në procesverbalin e vendshiqimit të lartcekur kjo nuk qëndron, pasi përmbaruesja e ka paraqitur në formë të shënimit zyrtar në procesverbalin e njëjtë të vendshiqimit, mirëpo e njëjta nuk e ka ndërruar në asnjë rast përmbarimorin e procesverbalit të vendshiqimit dhe nuk ka ndërhyrë në asnjë të dhënë të procesit . Pra, përmbaruesja vetëm ka paraqitur edhe një të dhënë që ,pasi është kthyer në zyre nga terreni, e njëjta e ka evidentuar në procesverbal.

Për këto arsye komisioni e ndërroi vendimarrjen paraprake në këtë rast dhe erdhi në përfundim se përmbaruesja lëndore nuk është përgjegjëse në këtë rast, për asnjërën nga shkeljet të përcaktuara me nenin 367 të LPP-së, sepse të gjitha veprimet përmbarimore për rastin për të cilin është paraqitur ankesa , janë në harmoni me dispozitat e LPP-së.

Sa i për këtë pretendimit të përmbaueses lëndore për kthimin e mjeteve në shumën prej 500.00 euro të paguar nga përmbauesja private sipas vendimit të Komisionit Disiplinor për Përmbauesit Privat DPL-03/2019 të datës 03.04.2019, nuk është në juridiksionin e këtij komisioni që të vendos lidhur më këtë pretendimin, por nëse edhe më tutje përmbauesja pretendon lidhur me këtë çështje, mund të inicon procedurë tjetër për realizimin eventual të të drejtave të saj.

Mbi bazën e të dhënave si më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT

DPL.nr.03/2019 datë 25.09.2023

Kryesuesja e Komisionit Disiplinor

Manushe Karaçi



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374, par 5 të LPP-së.